

## MONITORIMI I PROCESIT TË PROKURIMIT NË KOMUNËN E PRISHTINËS PËR ÇMIMET E MASKAVE NË KOMUNËN E PRISHTINËS



U monitorua dosja me titull **“Furnizimi me pajisje mjekësore mbrojtëse për punëtorët shëndetësor të QKMF dhe QMU”** me numër prokurimi 616 20 042 1 2 5.

Procedura e prokurimit: **E negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë.**



Me datën 23 prill 2020 është kontraktuar operatori ekonomik N.SH.T. “Made-KOS” për furnizim me maska kirurgjike, maska FFP2, alkool, dezinfektues për hapësirë, dezinfektues për duar dhe veshje me mbulim të plotë me vlerë totale prej 49,374.00 €.



Ekipi hulumtues siguroi një ofertë për të njëjtat produkte tek “Bionics Sh.P.K” me të njëjtën sasi me pothuajse gjysmë çmimi më pak se kontrata mes Komunës së Prishtinës dhe N.SH.T. Made-KOS, përkatësisht me një total prej **29,134 €.**



Komuna e Prishtinës pagoi **0.40 cent / copë për 5000 maska kirurgjike**, një muaj më vonë i pagoi **10000 sosh me 0.50 cent / copë** te i njëjti operator ekonomik.



Ndryshimet në çmimet e paguara nga Komuna e Prishtinës u vërejtën edhe në alkool për dezinfektim, ku për një litër **“Alkool 70%” pagoi 7.95 € / litër** – Komuna e Skenderajt u furnizua me të njëjtin produkt me çmim 3 € / litër.



Për më tepër, operatori ekonomik i faturoi Komunës së Prishtinës **400 palë rroba mbrojtëse “Coverall” me madhësi XXL me çmim 11 € / copë**, përderisa një muaj më vonë për **350 copë të njëjtit model është paguar çmimi prej 12.60 € / copë.**



Komuna e Prishtinës pagoi **8.50 Euro/cope pper maskat FFP2 me valvule /filter, pothuajse trefish më shumë** krahasuar me Komunën e Skenderajt e cila ka paguar 3 € / copë.



### REKOMANDIM



Komuna duhet të hulumtojë tregun para se të kontraktojë produkte, sidomos në raste të krizave siç ishte pandemia. Hulumtim bazik i tregut do të mund t'i kursente Komunës së Prishtinës një shumë të konsiderueshme të hollave të taksapaguesve.